



Historia e një debati – pjesa e I

Description

Hafiz Ali Korça

Një bisedë në vaporr me disa zotërinj të ndryshëm në Fet

PJESA E I- *Hafiz Ali Korça*

Me një të krishter një ditë,
fjal u çil mbi historitë.
Shkoj biseda gjër e gjatë,
s'mbet as e njom, as e thatë.
Në fund tha myslimanizma,
lindi nga krishtjanizma.
Musevizëm rrënj e kanë,
rezume e saj janë.
Krishti bir i Perëndisë
qish drit e gjithësisë,
gjithë botën për të shpëtuar,
fërtomën e pat pushtuar.
Kësi soj u la mëkati
dhe u ngjall, shkoj ne i ati.
Kurse Zoti zbriti vetë,
fesë gjë s i la të metë.
Pas Krishtit më s pat nevojë,
përmbi fe të çilet gojë.
Më s kish nevojë mileti,
që të delte Muhamedi (a.s)
? bëri pra edhe se dolli,
veç ngatërrimet që solli.
Kombin me komb e përfyty,
botën në gjakra e mbyti.
Kësi soj tha shumë fjalë,
me një gjuhë, pret si pallë.
Ardhi rradha të flas unë
për të quar këtë punë.
Në shesh të përgjegjes rashë,
i nderçëm vëlla i thashë:
Unë s them myslimanizma,
lindi nga kristianizma,
por them ajo është vetë,
pa shtim dhe pa të metë.
Ajo është musevizma,
ajo është brahamizma.
Se feja që fali Zoti,
si sot, dije, qëmoti,
një lloj ish, një do jetë,
se s gabon Zot i vërtetë.
Ai Zot që dha Teuranë,
dha Inxhilë dhe Kur anë.
I pari ç besim shënonte,
tjetri aspak s e cënonte.
Veç forconte njëri tjetrin,
sejcili ngjallte të vjetrin.
? pat besuar Ibrahim, i
besonte Musa Qelimi.
Ato besoj edhe Krishti,

për ato ngrihej dhe gishti.¹

Page 3
.Do me thënë Muhamedi (a.s)
besoj si Isa Profeti.

Date Created

14/01/2013

Author

erasmusi